



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 27
Prishtinë, më 04 maj 2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL
I Mbledhjes së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Synavere Rysha, Naim Fetahu, Fikrim Damka, Hajdar Beqa dhe Abdyl Ymeri.

Munguan: Besnik Bislimi, Bali Muharremaj dhe Enver Hoti.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës, dhe Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ-i.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Qëndresa Mulaj - ZAP, Agnesa Haxhiu-KDI dhe Dren Ajeti-GLPS.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.04.2016;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit përfundimtar për Projektligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;
4. Të ndryshme.

Zëvendëskryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Zëvendëskryetari konstatoi që aprovohet rendi i ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.04.2016

Zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 12.04.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit përfundimtar për Projektligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

Ali Sadriu, zëvendëskryetar, i njoftoi deputetët dhe të pranishmit se KMFP, sot, është mbledhur për të diskutuar raportin përfundimtar për Projektligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, bashkë me këtë edhe amendamentet e komisioneve të përhershme të Kuvendit. Komisioni për Legjislacion ka dhënë dy amendamente dhe Komisioni i Buxhetit, po ashtu, ka dhënë dy amendamente. Komisioni për Legjislacion ka propozuar që neni 8 i Projektligjit dhe amendamenti 18 i Komisionit Funkcional të fshihen.

Hajdar Beqa theksoi se neni 8 i Projektligjit të mos fshihet, por fjala “Gjykatës Kushtetuese” të zëvendësohet me fjalën “Gjykatës Kompetente”.

Naim Fetahu pyeti se nëse ne e heqim amendamentin 18 të KMFP, atëherë kush do ta bëjë spastrimin e gabimeve teknike dhe gjuhësore të tërë tekstit të Projektligjit?

Synavere Rysha shtoi se nëse nuk bëhet një korigjim gjuhësor tërë tekstit të Projektligjit atëherë për lexuesit do të jetë e vështirë të kuptuarit e dispozitave që jep ky Projektligj.

Hajdar Beqa theksoi se lekturimi i tekstit të Projektligjit duhet të bëhet nga sponsoruesi i Projektligji në fazën e hartimit të tij, dhe vetëm amendamentet e Komisionit Funkcional apo të komisioneve të përhershme të bëhen në Kuvend.

Abdyl Ymeri theksoi se nëse Projektligji në aspektin gjuhësor nuk ka qenë në rregull atëherë është dashur të kthehet te sponsorusi i Projektligjit.

Ali Sadriu, zëvendëskryetar, tha se meqë nuk pati të interesuar për të diskutuar për dy amendamentet e Komisionit për Legjislacion, propozim - amendamentet i hodhi në votim, të cilat u përkrahën njëzëri nga të gjithë deputetët e pranishëm.

Përfundim

KMFP, vendosi të përkrahën njëzëri të dy amendamentet e Komisionit për Legjislacion.

Ali Sadriu, zëvendëskryetar, vazhdoi me leximin e amendamenteve të Komisionit për Buxhet ku ky Komision ka dhënë amendamente të reja, dhe thuhet: Në nenin 4 të shtohen dy paragrafët e

rinj 8 dhe 9 me tekstin si vijon: 8. Niveli i Pagës së Auditorit të Përgjithshëm, caktohet me Ligjin përkatës që rregullon pagat e funksionarëve të lartë publikë, si dhe paragrafi 9, ku thuhet: Deri në miratimin e Ligjit përkatës, që rregullon pagat e funksionarëve të lartë publikë, paga e Auditorit të Përgjithshëm, caktohet nga Kuvendi. Unë mendoj se ne, si KMFP, mund t'i përkrahim amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, apo t'i dërgojmë në seancë si amendamente pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Me këtë e hapi diskutimin.

Naim Fetahu mendoi se amendamenti i KMFP, që flet për pagën e auditorit, është i qëlluar dhe se amendamentet e KBF nuk mendon se meritojnë përkrahje.

Synavere Rysha theksoi se amendamenti i parë i KBF nuk mendoj se duhet të përkrahet, ndërsa amendamenti i dytë mendoj se duhet ta ketë përkrahjen e KMFP- së.

Abdyl Ymeri theksoi se në amendamentin e parë, nuk ekziston një Ligj të paktën deri tani që e cakton pagën e Auditorit të Përgjithshëm, dhe si i tillë nuk mendoj se duhet të përkrahet, ndërsa për amendamentin e dytë mendoj se duhet të përkrahet.

Ali Sadriu, zëvendëskryetar, pasi nuk pati të interesuar për të diskutuar për dy amendamentet e Komisionit për Buxhet, e hodhi në votim amendamentin e parë të KBF-së, ku me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm nuk u përkrah amendamenti i parë. Po ashtu pas votimin me shumicën e votave të deputeteve të pranishëm është përkrahur amendamenti i dytë, i KBF-së.

Përfundim

KMFP, vendosi të mos e përkrahë amendamentin e parë të KBF-së, dhe njëzëri përkrahu amendamentin e dytë. Po ashtu KMFP njëzëri miratoi raportin përfundimtar për Projektligjin nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

1. Të ndryshme

Ali Sadriu, zëvendëskryetar, theksoi se në takimin e radhës së Komisionit do të diskutohet për raportet kthyesë të organizatave buxhetore që lidhen me adresimin e rekomandimeve të dala nga shqyrtimi i raporteve të auditimit nga viti i kaluar. Administrata e KMFP do të përgatitë raport për këtë. Me këtë u mbyll takimi.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zëvendëskryetari i Komisionit,

Ali Sadriu